

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar, Abdullah Ahmeti e Xhevdet Abazi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve, **F.H.** nga fsh. ... K. Podujeve për shkak të veprave penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 339 (1-3) të ish KPK-së, të lexuar në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 422 (1) dhe (6) të KPRK-së në lidhje me nenin 31, Mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 261 par.2 në lidhje me paragrafin 1 dhe me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 335 par.2 në lidhje me par.1 dhe në lidhje me nenin 31 të KPRK-së dhe Krimi i organizuar nga neni 274 par.1 dhe 2 të KPK-së, aktualisht sipas nenit 283 par.1 të KPRK-së. **N.U.** nga fsh.. K. Podujeve për shkak të veprave penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 339 (1-3) të ish KPK-së, të lexuar në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 422 (1) dhe (6) të KPRK-së në lidhje me nenin 31, Mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 261 par.2 në lidhje me paragrafin 1 dhe me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 335 par.2 në lidhje me par.1 dhe në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, Krimi i organizuar nga neni 274 par.1 dhe 2 të KPK-së, aktualisht sipas nenit 283 par.1 të KPRK-së dhe Krimi i organizuar nga neni 274 par.3 të KPK-së, aktualisht sipas nenit 283 par.2 të KPRK-së. **S.M.** nga Prishtina, për shkak të veprave penale, Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 346 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 432 të KPRK-së, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 339 (1-3) të ish KPK-së, të lexuar në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 422 (1) dhe (6) të KPRK-së në lidhje me nenin 31, Mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 261 par.2 në lidhje me paragrafin 1 dhe me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 335 par.2 në lidhje me par.1 dhe në lidhje me nenin 31 të KPRK-së dhe Krimi i organizuar nga neni 274 par.1 dhe 2 të KPK-së, aktualisht sipas nenit 283 par.1 të KPRK-së. **M.H-B.** nga Prishtina, për shkak të veprave penale, Legalizimi i përmbajtjes së falsifikuar në bashkëkryerje nga neni 334 (1) të ish KPK-së lidhje me nenin 31 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 403 (1) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, Mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 261 par.2 në lidhje me paragrafin 1 dhe me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 335 par.2 në lidhje me par.1 dhe në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme në bashkëkryerje nga neni 259 par.1 dhe në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 332 par.1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së dhe Krimi i organizuar nga neni 274 par.1 dhe 2 të KPK-së, aktualisht sipas nenit 283 par.1 të KPRK-së. **K.H.** nga Obiliqi, për shkak të veprave penale, Legalizimi i përmbajtjes së rreme në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 334 (1) të ish KPK-së në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 403 (1) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së, Legalizimi i përmbajtjes së falsifikuar në bashkëkryerje nga neni 334 (1) të ish KPK-së në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 403 (1) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, Mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 261 par.2 në lidhje me paragrafin 1 dhe me nenin 23 të ish

KPK-së, aktualisht sipas nenit 335 par.2 në lidhje me par.1 dhe në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajjtshme në bashkëkryerje nga neni 259 par.1 në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 332 par.1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së dhe Krim i organizuar nga neni 274 par.1 dhe 2 të KPK-së, aktualisht sipas nenit 283 par.1 i KPRK-së. **K.H.-U.** nga Prishtina për shkak të veprave penale, Legalizimi i përmbajtjes së rreme në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 334 (1) të ish KPK-së në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 403 (1) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së, Legalizimi i përmbajtjes së falsifikuar në bashkëkryerje nga neni 334 (1) të ish KPK-së në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 403 (1) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, Mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 261 par.2 në lidhje me paragrafin 1 dhe me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 335 par.2 në lidhje me par.1 dhe në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajjtshme në bashkëkryerje nga neni 259 par.1 në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 332 par.1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së dhe Krim i organizuar nga neni 274 par.1 dhe 2 të KPK-së, aktualisht sipas nenit 283 par.1 i KPRK-së. **H.M.** nga Prishtina për shkak të veprave penale, Legalizimi i përmbajtjes së falsifikuar në bashkëkryerje nga neni 334 (1) të ish KPK-së në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 403 (1) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, Mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 261 par.2 në lidhje me paragrafin 1 dhe me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 335 par.2 në lidhje me par.1 dhe në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajjtshme në bashkëkryerje nga neni 259 par.1 në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 332 par.1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së dhe Krim i organizuar nga neni 274 par.1 dhe 2 të KPK-së, aktualisht sipas nenit 283 par.1 i KPRK-së. **N.H.-M.** nga Obiliqi për shkak të veprave penale, Legalizimi i përmbajtjes së falsifikuar në bashkëkryerje nga neni 334 (1) të ish KPK-së në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 403 (1) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, Mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 261 par.2 në lidhje me paragrafin 1 dhe me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 335 par.2 në lidhje me par.1 dhe në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajjtshme në bashkëkryerje nga neni 259 par.1 në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 332 par.1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së dhe Krim i organizuar nga neni 274 par.1 dhe 2 të KPK-së, aktualisht sipas nenit 283 par.1 i KPRK-së. **I.H.-C.** nga Obiliqi për shkak të veprave penale, Legalizimi i përmbajtjes së falsifikuar në bashkëkryerje nga neni 334 (1) të ish KPK-së në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 403 (1) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, Mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 261 par.2 në lidhje me paragrafin 1 dhe me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 335 par.2 në lidhje me par.1 dhe në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajjtshme në bashkëkryerje nga neni 259 par.1 në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht sipas nenit 332 par.1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së dhe Krim i organizuar nga neni 274 par.1 dhe 2 të KPK-së, aktualisht sipas nenit 283 par.1 i KPRK-së. Duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Prokuroria Speciale dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve N.M., I.C., K.U., H.M., K.H. dhe M.H.-B., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prizren, PP.nr.376/2012 (P.nr.8/14) datë 21.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 16.04.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ato të mbrojtësve të akuzuarve N.M., I.C., K.U., H.M., K.H. dhe M.H.-B., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, PP.nr.376/2012 (P.nr.8/14) datë 21.10.2016, **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren me aktgjykimin, PP.nr.376/2012 (P.nr.8/14) datë 21.10.2016 ka marr aktgjykim refuzues kundër të akuzuarës S.M. për veprën penale Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 346 të ish KPK-së aktualisht sipas nenin 432 të KPRK-së, në bazë të nenit 363 par 1.3 të KPK-së në lidhje me nenin 106 par.1 nënpar.4 i KPRK, pasi që vepra penale është parashkruar. Po ashtu edhe ndaj të akuzuarve F.H., S.M. dhe N.U. për veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 339 par.1,2 dhe 3 ish KPK siç lexohet me nenin 23 të ish KPK aktualisht sipas nenit 422(1) dhe (6) të KPRK ,në bazë te nenit 363 par 1.3 të KPK-së në lidhje me nenin 106 par.1 nënpar.4 i KPRK , është refuzuar akuza pasi që ka kaluar afati i parashkrimit. Të akuzuarat K.H. dhe K.U. për veprën penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme në bashkëkryerje nga neni 334 (1) ish KPK lexuar së bashku me nenin 23 të ish KPK dhe neni 3 par.1 të KPRK-së janë shpallur fajtores, dhe në bazë të nenit 3 par 1 të KPRK-së dhe nenit 334 (1) ish KPK gjykohen me burgim prej 1 (një) viti. Të akuzuarat K.H., K.U., M.H.-B., N.M., H.M. dhe I.C. për veprën penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme në bashkëkryerje nga neni 334 (1) së bashku me nenin 23 të ish KPK dhe nenin 3 par.1 të KPRK-së janë shpallur fajtores, dhe në bazë te nenit 3 par.1 të KPRK-së dhe nenit 334 (1) të ish KPK gjykohen me dënim burgimi prej 1 (një) viti. Gjykata po ashtu ka refuzuar akuzën kundër të akuzuarve N.U., F.H. dhe S.M. për veprën penale Mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 261 par.2 në lidhje me par.1 dhe nenin 23 të ish KPK aktualisht sipas nenit 335 par.2 në lidhje me par.1 dhe ne lidhje me nenin 31 të KPRK sepse në pajtim me nenin 363 par. 1.3 të KPK në lidhje me nenin 3.2 dhe 106 par.1 nënpar.4 i KPRK ka kaluar afati i parashkrimit. Të akuzuarat K.H. dhe K.U. për veprën penale të Mashtrimit në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 261 par.2 në lidhje me par.1 dhe me nenin 23 të ish KPK neni 3 par.1 të KPRK janë shpallur fajtores, dhe në bazë te nenit 3 par.1 të KPRK-së dhe nenit 261 par.2 në lidhje me par.1 dhe me nenin 23 të ish KPK gjykohen me dënim burgimi prej nga 10 (dhjetë) muajve. Të akuzuarat K.H., K.U., M.H., N.M., H.M. dhe I.C. për veprën penale Mashtrimi në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 261 par.2 në lidhje me par 1 dhe me nenin 23 të ish KPK dhe neni 3 par.1 i KPRK janë shpallur fajtores dhe në bazë te nenit 3 par.1 të KPRK-së dhe nenit 261 par.2 në lidhje me par.1 dhe me nenin 23 të ish KPK gjykohen me dënim burgimi prej nga 10 (dhjetë) muajve. Të akuzuarat K.H., K.U., M.H., N.M., H.M. dhe I.C. për veprën penale Uzurpimi i pa ligjshëm i pronës së paluajtshme në bashkëkryerje nga neni 259 par.1 dhe në lidhje me nenin 23 të ish KPK janë shpallur fajtores dhe në bazë të nenit 3 par.1 të KPRK-së dhe nenit 81 i KPRK dhe neni 259 par.1 të ish KPK gjykohen me dënim burgimi prej 6 (gjashtë) muajve. Të akuzuarit N.U., S.M., F.H., K.H., K.U., M.H., N.M., H.M. dhe I.C. për veprën penale Krim i organizuar nga neni 274 par.1 dhe 2 të ish KPK, aktualisht sipas nenit 283 par.1 të KPRK, në bazë te nenit 364 par 1.3 të

KPK janë liruar nga akuza për këtë vepër penale. I akuzuari N.U. për veprën penale për pikën 12 - Krim i organizuar nga neni 274 par.3 të ish KPK, aktualisht sipas nenit 283 par.2 të KPRK, në bazë të nenit 364 par 1.3 KPK i akuzuari është liruar nga akuza për këtë vepër penale.

Në pajtim me nenin 80 par.1 dhe 2 nën par. 2.2 dhe 2.3 të KPRK-së, të akuzuarve iu është shqiptuar dënimi unik dhe atë:

2(dy) vjet për të akuzuarat K.H. dhe K.U., për kryerjen e veprave penale të përshkruara në pikën 3,4,6,7 dhe 8,9,10;

1 (një) vit e 10 (dhjetë) muaj për të akuzuarat M.H., N.M., H.M. dhe I.C., për kryerjen e veprave penale të përshkruara në pikën, 4,7 dhe 8,9,10.

Në pajtim me nenin 50, 51 par. 1 dhe 2, nenin 52 par.1 dhe 3 të KPRK ndëshkimi vendosur ndaj K.H., K.U., M.H., N.M. dhe I.C. pezullohet për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjet.

Në pajtim me nenin 276 dhe 284 të KPK e gjithë shuma e parave të depozituara në llogarinë bankare: NLB Prishtinë 1XXXXXXXXX, BPB 1XXXXXXXXX konsiderohet si përfitim material i veprave penale dhe si e tillë do të konfiskohet.

Në pajtim me nenin 275,276 dhe 284 të KPK parcela 5602 në lokacionin që tani quhet rruga nr.1 e quajtur më parë "...” ose rruga e "...”, ndërtesa e ndërtuar në Parcelën Tokësore 5602 lirohen. Komuna e”.....2 dhe motrat H. për të ardhmen e shtëpisë në fjalë duhet të paraqesin padi civile.

Në bazë të nenit 451 dhe 453 të KPK K.H., K.U., M.H., N.M., H.M. dhe I.C. janë të detyruar të paguajnë shpenzimet e procedurës penale në një shumë të vetme prej 50 euro lidhur me kryerjen e veprave penale në pikën 3,4,6,7,8,9 dhe 10.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

-Prokuroria Speciale për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që gjykata e Apelit të nxjerre një aktvendim në pajtim me nenin 402 të KPP dhe të anuloj refuzimin e akuzave për Pikat 1,2 dhe 5 për të pandehurit N.U., S.M. dhe F.H., t’ia kthej lëndën Gjykatës Themelore për rigjykim në lidhje me akuzat 1,2 dhe 5, ta vërtetoj dënimin e të pandehurve të tjerë, urdhrin për konfiskim dhe pjesët tjera, dhe në lidhje me veprat penale për të cilat është vërtetuar aktgjykimi dënuar të modifikoj aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Themelore në Prizren dhe të urdhëroj konfiskimin e prerë të dobisë pasurore të fituar nga kryerja e veprës penale përkatësisht asetëve në vijim të cilat i nënshtrohen konfiskimit, ngastra e tokës nr. 5602 në Komunën e "...” dhe ndërtesa e ndërtuar në ngastrën nr.5602.

-Mbrojtësi i të akuzuarës N.M., av. Q.Q., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të

procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që ankesa të aprovohet dhe aktgjykimi i shkallës së parë të anulohet, çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

-Mbrojtësi i të akuzuarës I.C., av. S.B. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa të aprovohet si a bazuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet ashtu që në bazë të nenit 364 par.1 e mbrojtura e tij të lirohet nga akuza apo në bazë nenit 402 par.1 aktgjykimin ta anuloj dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe konform dispozitave të nenit 275, 276 dhe 284 të KPP të merr vendim me të cilin të lirohen shumat e parave të depozituara në llogaritë bankare NLB dhe BPB.

-Mbrojtësi i të akuzuarës K.U. av. B.T. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që ankesa të aprovohet dhe aktgjykimi i shkallës së parë të anulohet dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje. Në bazë të nenit 390 par.2 të KPP kërkon që të njoftohen për seancë pasi në të njëjtën do të marrin pjesë dhe kërkon që të bëhet deblokimi i shumave të parave të depozituara në llogaritë bankare NLB dhe BPB.

-Mbrojtësi i të akuzuarës H.M., av. Q.M., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi konfiskimin e mjeteve të depozituara në bankë, me propozim që ankesa të aprovohet , aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet, e mbrojtura e tij konform nenit 364 par.1 të lirohet nga akuza, ose aktgjykimin e kundërshtuar ta anuloj dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe konform nenit 275,276 dhe 284 të lirohen mjetet e depozituara nën bankën NLB dhe BPB.

-Mbrojtësi i të akuzuarës K.H. ,av. H.K., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal dhe urdhrin për konfiskimin e parave, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet ashtu që e mbrojtura e tij të lirohet nga akuza dhe po ashtu të anulon masën për konfiskimin e mjeteve në të dy llogaritë bankare. Ose ta anuloj aktgjykimin dhe lënda të kthehet për rigjykim dhe rivendosje.

-E akuzuara M.H. për shkak të për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi urdhrin për konfiskimin e parave, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet ashtu që e akuzuara të lirohet nga akuza dhe po ashtu të anulon masën për konfiskimin e mjeteve në të dy llogaritë bankare. Ose ta anuloj aktgjykimin dhe lënda të kthehet për rigjykim dhe rivendosje. Dhe në bazë të nenit 390 par.2 kërkon që bashkë me mbrojtësin e saj të ftohen për seancën e kolegjit penal.

-Përgjigje në ankesën e PTH kanë bërë:

-Mbrojtësi i të akuzuarit N.U., av. T.R. i cili i propozon Gjykatës së Apelit e Kosovës ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar ankesën e Prokurorisë dhe aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë ta vërtetoi.

-Mbrojtësi i të akuzuarës K.U., av. B.T. me propozim që ankesa e Prokurorisë të refuzohet apo e njëjta të trajtohet si jo lëndore në momentin kur vendoset për këtë çështje.

-Mbrojtësi i të akuzuarit F.H., av.S.A. me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës sa i përket të mbrojturit të tij ta refuzoj si të pabazuar ankesën e Prokurorisë dhe aktgjykimin e shkallës së parë ta vërtetoi, gjithashtu kërkon nga Gjykata e Apelit që të ftohet për seancën e Kolegjit të Apelit.

-Mbrojtësi i të akuzuarës I.C., av. S.B. me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta refuzoj si të pa bazuar ankesën e Prokurorisë në pjesën që ka të bëjë me propozimin për Konfiskimin e Ngastrës Kadastrale 5602 të Komunës së “”..” dhe ndërtesën e ndërtuar në këtë ngastër, ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë, në pjesën ku janë liruar këto asete ta vërtetoi.

-Mbrojtësi i të akuzuarës N.M., av. Q.Q. me propozim që ankesa e Prokurorit të refuzohet apo e njëjta do të trajtohet si jo lëndore në momentin kur vendoset në këtë çështje penale.

-Mbrojtësi i të akuzuarës S.M., av. V.V. propozon që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën e Prokurorisë ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar, pasi që nuk do koment se kemi të bëjmë me parashkrim relativ të ndjekjes Penale.

-Mbrojtësi i të akuzuarës K.H., av. H.K. propozon që Gjykata e Apelit e Kosovës ta refuzoj si të pa bazuar ankesën e Prokurorisë pasi që mendon se nuk ka mbështetje ligjore në ankesën e parashtruar.

-Përgjigje ndaj ankesave të mbrojtjes ka parashtruar Prokurori i Prokurorisë Speciale me propozim që ankesat të shpallen të pa pranueshme dhe të refuzohen si të pabazuara.

Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.431/2017 të dt. 16.11.2017 ka propozuar që Gjykata e Apelit të refuzoj ankesat e paraqitura në emër të akuzuarve si të pa bazuara, ta refuzoj ankesën e paraqitur nga Prokuroria Speciale në pjesën ku e kundërshton pjesën e lirit për shkak të parashkrimeve, ta aprovoj pjesën e mbetur të ankesës së Prokurorisë Speciale dhe ta ndryshoj aktgjykimin e kundërshtuar duke vendosur mbi masat e konfiskimit.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesat nuk janë të bazuara.

-Prokuroria me ankesë pretendon se pavarësisht se nuk e kundërshton lirimin për veprë penale të Krimin të organizuar megjithatë arsyetimi për këtë shfaqësim duhet të kundërshtohet në atë masë pasi që përmban gabime të dukshme ligjore. Trupi gjykues jep një shpjegim konfuz për lirim të pandehurve nga akuza për Krimin të organizuar dhe se aktgjykimi merret në të njëjtën kohë me çështjet e lidhjes midis krimin të organizuar dhe veprës bazë, qëllimit specifik dhe mungesës së provave për sjellje kriminale. Këto janë subjekte të pa lidhura dhe të veçanta. Analiza lidhur me krimin e organizuar është tërësisht e gabuar. Prokuroria është e vetëdijshme se Kodi Penal i mëparshëm ka kërkuar që vepra e Krimin të organizuar të ketë së paku një veprë të rëndë bazë por pavarësisht nga kjo Kodi ka kërkuar që vepra bazë e lidhur me të është kryer por jo që ka një dënim për atë veprë penale dhe se fakti se kinse veprat bazë nën pikën 1, 2 dhe 5 kanë arritur parashkrimin nuk i fshin ato nga realiteti. Grupi kriminal i organizuar nuk zhduket nëse nuk ka asnjë dënim për veprat bazë për shkaqe procedurale si amnistia, falja kufizimi ligjor ose kur vepra bazë ndodh jashtë juridiksionit të vendit. Nëse gjykata beson se vepra penale e krimin të organizuar është e bazuar në këto raste atëherë duhet të vlerësoj provat për veprat bazë dhe nëse akuzat koresponduse do të refuzohen ose nuk do të gjykohen për arsye procedurale. Nëse gjykata konstaton se një apo më shumë anëtarë të grupit kanë kryer veprën bazë penale të lidhur kjo duhet të rezultojë në cilëndo mënyrë me një aktgjykim fajësues për veprën penale të krimin të organizuar. Këtë gjykata e thekson edhe vetë në faqen 47 të aktgjykimit duke cituar thëniet “se trupi gjykues ndan mendimin e paraqitur dhe të mbështetur në dëshmi të shumta të prokurorit se N.U. ishte një organizator i kësaj ndërmarrjeje që e planifikoi, organizoi dhe zbatoi duke përdorur njohurit e tij ligjore, pozicionet e tij të rëndësishëm dhe marrëdhëniet me gjykatësen S.M. dhe ekspertin F.H. e po ashtu i potencion edhe thëniet e gjykatës në faqen 48 dhe 49 se N.U. ka keqpërdorur pozitën zyrtare ose autoritetin dhe ka kryer veprën penale të mashtrimit në dëm të Komunës së “...” prandaj trupi gjykues e ka kuptuar qartë se veprat bazë ishin kryer edhe nëse ata mendonin se të akuzuarit nuk mund të shpallehin fajtor për shkak të parashkrimit. Sa i përket veprës së krimin të organizuar vihet re se neni 283 i Kodit të Ri Penal është krejtësisht ndryshe nga dispozita tjetër dhe nuk kërkon që veprat penale bazë të jenë kryer. Prokuroria e kundërshton parashkrimin e veprave penale bazë duke theksuar se periudha e parashkrimit është ndërprerë me kohë me veprimet e ndërmarra me qëllim të ndjekjes penale si dhe duke theksuar se periudha e parashkrimit nuk rrjedhë pas ngritjes së aktakuzës. Shton se vepra penale nën pikën 5 ka një klasifikim të ndryshëm ligjor dhe një periudhë të ndryshme parashkrimi. Se gjykata ka qenë e obliguar të gjykonte substancën e akuzave nën pikat 1, 2 dhe 5 dhe ajo dështoi që ta bëjë këtë. Sa i përket konfiskimit gjykata vendosi të mos urdhëroj të ngastrës së tokës nr. 5602 dhe të ndërtesës së ndërtuar në të por që të “liroi” pronat duke theksuar se ato duhet ti lirohen pronarit të vërtetë të pronës që është Komuna e “...”, e që nuk është e qartë dhe specifike.

-Mbrojtësi i të akuzuarës N.M., av. Q.Q. në ankesën e tij thekson se aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk është përpiluar konform dispozitës së nenit 370të KPP, ky aktgjykim nuk është përpiluar edhe konform dispozitës 361 par.1 dhe par.2 të KPP. Këto dy paragraf të këtij neni e detyrojnë Gjykatën që “aktgjykimin ta bazon vetëm në fakte dhe provat e proceduara në shqyrtim gjyqësorë, ndërkaq paragrafi 2 e detyron gjykatën “që me ndërgjegje të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerr

përfundim nëse fakti konkret është provuar” Ky aktgjykim në pjesën dërmuese të tij apostrofon veprimet për të cilat gjykata vlerëson e janë veprime inkriminuese të Zt.N.U. i cili në kohën kur pretendohet se janë kryer veprat penale ka qenë kryetar i Gjykatës Komunale në Prishtinë. Me aktgjykim siç është edhe më sipër akuza është refuzuar për të gjitha veprat ndaj Zt.U për shkak të parashkrimit. Paraqitet çështja kruciale se një aktgjykim refuzues a mund të merret si bazë për të vërtetuar përgjegjësinë penale të akuzuarve të tjerë të cilët janë shpallur fajtorë. Besoj se lidhur me këtë pretendim të mbrojtjes Gjykata e Apelit do të jap qëndrimin e caktuar. Në asnjë pjesë të aktgjykimit nuk janë paraqitur fjalët përmbyllëse të avokatëve mbrojtës dhe pretendimet e tyre. Gjykata ka qenë e detyruar që në secilën fjalë përmbyllëse të avokatit mbrojtës të jap përgjigje të caktuar se a është e njëjta e bazuar apo jo dhe qëndrimin e sajë pavarësisht se cilin opsion e pranon. Pavarësisht qëndrimit të gjykatës së paraqitur në aktgjykimin e ankimuar e që besoj se është jo i drejtë me gjendjen e fakteve gabimisht të vërtetuar mbrojtja vlerëson se kjo çështje penale e të mbrojturës sime dhe motrave të saj në bazë të gjitha provave në mënyrë të pa kontestueshme është vërtetuar: veprimet e të mbrojturës sime që janë të saktësuara në dispozitivet e aktgjykimit të detalizuara në pasuset e mësipërme përsëriten janë veprime tërësisht identike baza e veprave penale gjithashtu është tërësisht identike e në bazë të këtyre veprimeve gjykata gjen se kemi të bëjmë me veprat penale legalizim i dokumentit të pavërtetë nga neni 334 par.1 dhe mashtrim nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPK. Gjithashtu në aktgjykim nuk janë të saktësuara veprimet e secilës të akuzuar veç e veç e kjo rrethanë respektivisht veprimet e saktësuara veç e veç është njëri prej kushteve qenësore për të u kualifikuar një vepër penale e kryer në bashkë ekzekutim. Në bazë të aktvendimit për ndërrimin e banesës me L.R. tani i ndjeri M.H. ka lidhur kontratë me BVI-in nr. 1193/2176 dt. 26.11.1986 mbi shfrytëzimin e banesës dhe në të njëjtën me të gjithë anëtarët e familjes është vendosur për të jetuar. Në bazë të kësaj drejte të fituar të kësaj shtëpie-banese ka lidhur kontratë me Komunën e “...” për blerjen e sajë e cila kontratë është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë VR.nr.12702/93 dt. 02.12.1993. Shtëpia është ndërtuar në ngastrën kadastrale nr. 5602 ZK Prishtinë rr. Në afërsi të kësaj rruge më parë ka qenë i emërtuar Sheshi “...” më pastaj Sheshi “.....” të dy këto emërtime asociojnë me ditën e çlirimit të “...” dhe në kontratën e BVI-së për banim në Prishtinë për shfrytëzimin e banesës në emër të L.R. me të cilën i ndjeri M.H. ka bërë ndërrimin e banesës së tije, gabimisht është shkruar emri i rrugës Sheshi “...” në vend që të shënohet “Rr.t nr. 1” siç qëndron në aktvendimin e Komunës së “...” e cila asaj ia ka dhënë në shfrytëzim banesën-shtëpinë lidhur me emërtimin e rrugës së shtëpisë-banesës është përsëritur edhe më vonë në të gjitha dokumentet e lëshuara për këtë shtëpi në emër të M.H.t. Në Kosovë regjimi juridik i tokës ndërtimore ka qenë dhe ende është i rregulluar me Ligjin mbi tokën ndërtimore. Lidhur me këtë ligj edhe neni 24 i atij ligji ka rregulluar kjo se “pronari i ndërtesës së ndërtuar në tokën e ndërtuar urbane-ndërtimore ka të drejtë që ta shfrytëzoj tokën nën ndërtesë dhe tokën që është e nevojshme për përdorimin e sajë të rregullt në kufijtë e caktuar të tokës ndërtimore”. Në çoftë së ndërtesa nga alineja 1 e këtij neni është e pa përshtatshme për shfrytëzim në çoftë së vjetërsohet ose prishet për shkak të fuqisë madhore pronarit të ndërtesës i pranohet e drejta e përparësisë së ndërtimit në parcelën e njëjtë ndërtimore sipas kushteve nga neni 18 i këtij ligji. Me asnjë aktgjykim të secilës do gjykatë të Republikës së Kosovës nuk mundet me u ndryshua regjimi juridik i tokës e cila sipas ligjit ka qenë emërtuar dhe formalisht ende është “pasuri shoqërore”. E mbrojtura ime si dhe motrat e sajë në mënyrë të kundërligjshme pra është shpall fajtor se paska uzurpuar të tërë sipërfaqen e tokës 97 m2 të cilat kanë qenë nën shtëpinë e cila ka ekzistuar para më se 60 vite.

-Mbrojtësi i të akuzuarës I.C., av. S.B. në ankesë thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës

së parë nuk është përpiluar konform dispozitës së nenit 370 të KPP kjo për faktin se kjo dispozitë ligjore saktësisht precizon formën, mënyrën dhe afatet se si duhet të përpilohet aktgjykimi në formë të shkruar. Ky aktgjykim nuk është përpiluar edhe konform dispozitës së nenit 361 par.1 dhe par.2 të KPP. Këto dy paragrafë të këtij neni e detyrojnë gjykatën që aktgjykimin ta bazon vetëm në fakte dhe prova të procedura në shqyrtim gjyqësor, që në ndërgjegje të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar. Në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar në mënyrë selektive janë përfshi dëshmitë e dëshmitarëve (L.R., N.B. dhe L.N.” por jo edhe tërësia e tyre ndërsa disa nga dëshmitarët e propozuar nga ana e mbrojtjes fare nuk i ka marr në pyetje për të cilët do të bëhet fjalë më poshtë. Në asnjë pjesë të aktgjykimit nuk janë paraqitur fjalët përfundimtare të mbrojtjes dhe pretendimet e tyre. Pavarësisht se cilin opsion e pranon gjykata ajo është e detyruar të jep përgjigje në secilën pjesë të fjalëve përfundimtare. Aktgjykimi i kundërshtuar përmban në vete shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën. par 1.11 lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPK, shkelje të Ligjit Penal nga neni 385 par.1 të KPP dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike par.2 dhe 3 të KPP. Lidhur me veprën penale legalizim i përmbajtjes së pavërtetë në bashkëkryerje nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPP pika 4 e dispozitivit të aktgjykimit e mbrojtura ime dhe motrat e sajë janë fajtoare për kryerjen e kësaj vepre sepse në mes të datës 21.shtator 2010 dhe 8 nëntor të vitit 2010 në Prishtinë kanë përdorur një dokument me përmbajtje të rreme, kontratën mbi dhuratën për të mashtruar autoritetet kompetente përkatësisht Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe Zyrën Komunale kadastra le në Prishtinë për të vërtetuar një çështje të pa vërtetë (d.m.th. Se ato u benën bashkëpronare të një shtëpie dhe oborri në parcelën e tokës nr. 5602) i cili është projektuar për të shërbyer si dëshmi në një çështje ligjore në një dokument regjistër ose libër publik që është në vendimin e ZKK të “...” të datës 8.nëntor 2010 për të dhënë një ndryshim të pronësisë ligjore të parcelës së tokës nr. 5602. Dokumentet ishin mashtrues dhe të pa vërteta sepse të pandehurat janë betuar se në parcelën tokësore në vitin 2010 ekziston një shtëpi dhe oborr kur në fakt shtëpia ishte rrënuar 2003/2004 dhe një ndërtesë e madhe komerciale ishte ndërtuar në mënyrë të paligjshme në vitin 2004/2005 në të gjithë parcelën duke përfshirë dhe oborrin tashmë jo ekzistues. Në veprimet e të mbrojturës sime dhe motrave të sajë nuk ekziston asnjë element i veprës penale të Legalizimit të përmbajtjes së pa vërtetë nga neni 334 par.1 të KP. Për ekzistimin e kësaj vepre penale organi kompetent duhet të vihet në lajthim për të vërtetuar një çështje të pa vërtetë e cila duhet të shërbej si provë në një çështje ligjore në një dokument publik në një regjistër ose libër. Vendimin që një aktgjykim është i kundërligjshëm e nxjerrin gjykata e instancave më të larta dhe askush tjetër. Lidhur me veprën penale Uzurpim i kundërligjshëm i pronës së paluajtshme në bashkëkryerje nga neni 259 par.1 lidhur me nenin 23 të KPP kjo veprë ekziston vetëm atëherë kur duhet të realizohet përfitimi duke e mbajtur në mënyrë të kundërligjshme pronën e personit tjetër. Nuk mund të uzurpohet sendi i paluajtshëm të cilin personi e ka në posedim prandaj në rastin konkret nuk formësohen elementet e veprës penale të uzurpimit të kundërligjshëm të pronës së paluajtshme. E mbrojtura ime me prindërit dhe motrat e sajë kanë hy në posedim të shtëpisë dhe oborrit të sajë e cila gjendet në parcelën kadastra le nr. 5602 ZK Prishtinë në vitin 1986. Lidhur me faktet e vërtetuara në kapitullin e aktgjykimit të kundërshtuar “faktet e vërtetuara” që fillon në faqen nr. 15 dhe përfundon në faqen nr. 34 është bërë përshkrimi i aktakuzës e cila bazohet në thashetheme dhe supozime dhe nuk ka mbështetje në prova të cilën mbrojtja e ka kundërshtuar me kërkesën për hudhjen e saj si dhe në detaje në fjalën përfundimtare.

-Mbrojtësi i të akuzuarës K.U.j, av. B.T. , me ankesë pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përpiluar konform dispozitës së nenit 370 të KPP. Kjo dispozitë saktësisht precizon formën, mënyrën dhe afatet se si duhet të përpilohet aktgjykimi në formë të shkruar. Ky aktgjykim nuk është përpiluar edhe konform dispozitës së nenit 361 par.1 dhe par.2 të KPP. Këto dy paragrafë të këtij neni e detyrojnë gjykatën që aktgjykimin ta bazon vetëm në fakte dhe prova e procedura në shqyrtim gjyqësor ndërsa paragrafi 2 e detyron gjykatën që me ndërgjegje të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar. Në këtë çështje penale në shqyrtimet gjyqësore janë dëgjuar gjithsej 15 dëshmitar, me këto dëshmi gjykata e shkallës së parë ka tentuar që ato pjesë të tyre të i përdorë për të dëshmuar se përgjegjësi kryesor në këtë çështje penale është i akuzuari N.U. (ndaj të cilit aktakuza është refuzuar për shkak të parashkrimit). Ky aktgjykim në pjesën dërmuese të tij apostrofon veprimet për të cilat gjykata vlerëson se janë veprime inkriminuese të Zt.N.U. i cili në kohën kur pretendohet se janë kryer veprat penale ka qenë kryetar i gjykatës Komunale në Prishtinë dhe të gjitha këto veprime ndërlidhen me afërsinë familjare të tani të ndjerit M.H. me të mbrojturën time K.U. e cila është bashkëshortja e Zt.N.U.. Në aktgjykim nuk janë të saktësuara veprimet e secilës të akuzuar veç e veç e kjo rrethanë respektivisht veprimet e saktësuara veç e veç është njëri prej kushteve qenësore për të u kualifikuar një vepër penale e kryer në bashkë ekzekutim. Në aktgjykim në raport me të mbrojturën time dhe të dyshuarat tjera gjykata nuk ka paraqitur diçka specifike e i cili specificitet kishte përmbushur këto kushte të paraqitura më sipër përveç asaj që gjykata ka përshkruar mënyrën e lidhjes së kontratës mbi dhuratën në mes të mbrojturës sime dhe K.H.t dhe i cili dokument kësaj kontrate i ka parapri e më pas ndërrimet kadastra le që janë bërë sipas kësaj kontrate. Sipas marrëveshjes me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë të formës së prerë R.nr.343/86 paraardhësi i të akuzuarave dhe dëshmitarja kanë bërë ndërrimin e banesave. Në bazë të këtij aktvendimi tani i ndjeri M.H. ka lidhur kontratë me BVI-së nr. 1193/2176 të dt. 26.11.1986 mbi shfrytëzimin e banesës dhe në të njëjtën me të gjithë anëtarët e familjes është vendosur për të jetuar. Në bazë të kësaj të drejtë të fituar të kësaj shtëpie-banese ka lidhur kontratë me Komunën e “...” për blerjen e sajë e cila kontratë është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë VR.nr.12702/93 të dt. 02.12.1993. Për shkak të tejkalimit të lejes ndërtimore me rastin e ndërtimit të shtëpisë tani e ndjera A.H. me datë 24.09.2010 Komisionit të Komunës së “...” i ka bërë kërkesë për legalizimin e pjesës së shtëpisë për shkak të tejkalimit të lejes ndërtimore bazuar në Rregulloren e Komunës së “...” për trajtim ndërtim pa leje të vitit 2009. Kjo kërkesë ende nuk është vendosur mirëpo pritet që vendimi të merret më shpejtë për shkak se tani është aprovuar Ligji mbi trajtimin e objekteve të ndërtuara pa leje të Kosovës Ligji nr. 04/L-188. Për hire të ruajtjes së qetësisë familjare e me qëllim që mos të shfaqet ndonjë dyshim për sa i përket diskriminimit në raport me motrat e tjera është lidhur kontrata mbi dhurimin e cila gjithashtu është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe se tani si dhurate marrëse paraqiten motrat tjera. Në bazë të këtij dokumentacioni pa mëdyshje vërtetohet se patundshmëria e cila përbehet prej ndërtesës në sipërfaqe prej 97 m2 dhe oborrit prej 69 m2 nga 1/6 janë bashkëpronare të gjitha motrat dhe bashkë shfrytëzuese të oborrit në sipërfaqe prej 69 m2 e cila gjendje ekziston edhe sodë e kësaj dite në librat kadastra le të Zyrës Komunale Kadastra le në Prishtinë. Nga kjo që u tha më sipër lidhur me veprat penale Legalizim i Përmbajtjes së rreme mbrojtja konsideron se nuk përmbushet asnjëri prej elementeve që saktësojnë elementet e qenies së veprës penale nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK ndërsa në raport me veprat penale Mashtrimi nga neni 261 gjithashtu edhe për këtë nuk përmbushet as kushti minimal ligjor e aq më tepër për të njëjtat veprime është absurd që të

iniciohet procedura për më shumë vepra penale pasi që për ekzistimin e veprës penale Mashtrimi është e nevojshme të ekzistoj dashja. Për sa i përket veprës penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme përveç kriterëve të tjera për të ekzistuar kjo veprë duhet të plotësohen edhe kushtet tjera, në këtë pronë uzurpuesi duhet të realizoj përfitime duke mbajtur në mënyrë të kundërligjshme. Përgjegjësia penale për këtë veprë është individuale, veprimi gjithashtu duhet të jetë individual. Me këtë ngastër janë bërë vetëm ndërrimi i pronarëve pa u ndryshuar përmbajtja e sajë. Të gjitha të drejtat që e mbrojtura ime i ka realizuar janë të drejta që i takojnë me Ligj, e drejta e trashëgimisë që në kontratën mbi dhurimin në nenin 1 të sajë nuk është shënuar asnjë element më tepër sesa ato elemente që janë të saktësuara në fletën poseduese-certifikatën e pronës.

-Mbrojtësi i të akuzuarës H.M., av. Q.M. thekson se aktgjykimi i kundërshtuar është i kundërligjshëm pasi që përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se dispozitivi i aktgjykimit në pikat 4,7,8,9 dhe 10 është i pakuptueshëm dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit. Në aktgjykim nuk janë dhënë arsyet lidhur me faktet relevante të kësaj çështje penale kurse ato që janë dhënë janë të pa qarta në masë të konsiderueshme kundërthënëse. Kjo për faktin se ndërmjet asaj që është paraqitur në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave dhe të procesverbaleve për deklarimet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre procesverbaleve ekzistojnë kundërthënje të konsiderueshme që aktgjykimin e bëjnë të paqëndrueshëm. Së pari theksojmë se e pandehura H.M me motrat e saj me aktgjykimin e kundërshtuar shpallen fajtores për veprimet e njëjta por për disa vepra penale dhe atë të legalizimit të përmbajtjes së pavërtetë dhe veprën penale të mashtrimit që nuk mund të qëndrojnë si të tilla pasi që njëra e konsumon tjetrën si dhe veprave penale të uzurpimit nën pikën 8,9 e 10. Së pari një kundërthënje e tillë manifestohet në faqen 57 dhe 60 të aktgjykimit të kundërshtuar – version shqip, ku në njërin anë këtë çështje e trajton si çështje civile që në si mbrojtje e kemi theksuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kurse në anën tjetër Gjykata thirrret në aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev.144/05 të dt. 22.06.2006 duke u përpjekur të arsyetoj ekzistimin e veprave penale të legalizimit të përmbajtjes së rreme nga neni 334 dhe veprës penale të mashtrimit nga neni 261 duke e harruar faktin që Gjykata Supreme i kishte vërtetuar aktgjykimet për pronësinë e shtëpisë në parcelën kadastra le nr. 5602 kurse në rigjykim e kishte kthyer çështjen vetëm për të drejtën e shfrytëzimit të oborrit. Sa i përket veprës penale Legalizim i përmbajtjes së pavërtetë përshkrimi i kësaj pike të aktgjykimit është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm sepse bazohet vetëm në supozime pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar që e mbrojtura ime dhe motrat e sajë të kenë përdorur ndonjë dokument me përmbajtje të ndryshuar apo të falsifikuar si provë për ndryshimin e parcelës kadastra le në fjalë. Sepse në ekzistimin e kësaj veprë penale organi kompetent duhet të vihet në lajthim kryerësi me dashje direkt për të vërtetuar një çështje të pa vërtetë për tu shërbyer me të si provë në një çështje ligjore, në një dokument publik ose ndonjë regjistër. Sa i përket veprës penale të Mashtrimit, ky përshkrim i dispozitivit të aktakuzës është pothuajse i njëjta me atë të dispozitivit paraprak të cituar më lartë, nuk është argumentuar me asnjë provë gjatë seancave gjyqësore dhe si i tillë nuk përmbante asnjë veprim inkriminues, kjo për faktin se vepra penale e mashtrimit kryhet me dashje direkte duke e vënë personin tjetër në lajthim në mënyrë që ai të vihet në atë gjendje që të veprojnë në dëm të pronës së tij ose të pronës së tjetrit me qëllim të përfitimit të dobisë së kundërligjshme pasurore për veten ose për tjetrin. Në rastin konkret në veprimet e të mbrojturës time dhe motrave të sajë nuk qëndrojnë asnjë nga elementet e kësaj veprë penale. Kjo për faktin se të pandehurat me vërtetimin e nënshkrimeve në kontratën e dhurimit pranë gjykatës siç u theksua

më lartë në zyrën kadastra le kanë bërë regjistrimin vetëm të atyre të drejtave pronësore të cilat i ka pasur paraardhësja e tyre – nëna e ndjerë A.H. në parcelën kadastra le 5602. Pra Komuna e “...” ia kishte shitur tani të ndjerit M.H. në vitin 1993 në pajtim me dispozitat e ligjit mbi banim që ishte i aplikueshëm në Kosovë me rastin e shitblerjes së banesave të cilës shtëpi i ishte paguar çmimi kontraktues dhe me blerjen e sajë tani i ndjeri kishte fituar edhe të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm të oborrit, ashtu që Komune e “...” në asnjë mënyrë nuk ish vënë në lajthim apo mashtruar e as që ishte e dëmtuar, siç thuhet pa kurrfarë baze në aktgjykimin e kundërshtuar. Në pikën 10 të dispozitivit të aktakuzës thuhet se e mbrojtura ime dhe motrat e sajë në mënyrë të paligjshme kanë uzurpuar parcelën nr. 5602 ose një pjesë të sajë të Komunës së “...”, mbrojtja thekson se vepra penale uzurpim i kundërligjshëm ekziston atëherë kur kryerësi mban në mënyrë të kundërligjshme pronën e personit tjetër siç është hyrja në objekt, banesë shtëpi lokal etj. Nga e gjithë kjo që u cekë ë lart rezulton se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e që gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ku edhe ligji penal është aplikuar në mënyrë të gabuar.

-Mbrojtësi i të akuzuarës K.H., av. H.K. thekson se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të procedurës penale në faktin se gjykata e shkallës së parë disa prej provave fare nuk i ka paraqitur, disa i ka paraqitur në mënyrë selektive e jo në mënyrë të plotë dhe të çartë siç e parashikon dispozita e nenit 370 par.7 të KPPK-së. Prova të cilën kjo gjykatë fare nuk e ka paraqitur dhe fare nuk e ka vlerësuar as tërësisht e as sipërfaqësisht e as ka shtruar fillimisht e theksojmë se është mbrojtja e të autorizuarit – mbrojtësit të akuzuarës K. por ndaj të njëjtës sillet sikurse mos të ishte paraqitur fare, të tjera prova qe nuk janë paraqitur janë ekspertimet dhe dëgjimet e ekspertëve E.Q., Q.F., SH.P. dhe Q.H., sipas kësaj zgjidhje ligjore të gjitha njësit kadastrale duke përfshirë edhe ndërtesat mund të jenë objekt qarkullimi –bartjeje nga një person në tjetrin. Gjykata në rastin konkret ka shkelur rëndë edhe dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me përcaktimin e dobisë pasurore kinse të fituar me vepër penale e që kanë të bëjnë me përcaktimin e dobisë pasurore kinse të fituar me vepër penale e që ai konstatim është në kundërshtim edhe me vetveten shihet nga konstatimi i saj në faqen 56 të aktgjykimit. Meqë bartësi i të drejtës së shfrytëzimit të përhershëm së tokës i ka të gjitha të drejtat të cilat i ka bartësi i të drejtës së pronësisë atëherë gjykata është dashur gjithsesi për të dhënë përgjigje tjetër në atë se mbi çfarë baze Komuna e “...” qenka pronare e parcelës nr. 5602 ZK Prishtinë dhe njëkohësisht pse qenka e dëmtuar sepse ajo siç e ka dhënë na rezulton se është e qëndrueshme. Mos theksimi i të gjitha këtyre rrethanave e bëjnë të paqartë dhe të pakuptueshëm aktgjykimi. Aktgjykimi gjithashtu ka mungesë edhe në pikëpamje faktike, pasi sipas mbrojtjes gabimisht janë vërtetuar faktet relevante dhe për këtë shkak ka ardhur në konkludimin e gabuar se e akuzuara K. ka kryer vepër penale për të cilën është shpallur fajtores, konkludimet e përmendura në dispozitave të aktgjykimit janë tërësisht të pa bazuara kjo për faktin se formulimi i këtyre pikave të aktakuzës janë të paqëndrueshme dhe janë të bazuara vetëm në supozime. Si rezultat i vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike është bërë edhe shkelja e ligjit penal, se gjendja siç është përshkruar në arsyetim të aktgjykimit nuk është vlerësuar drejtë e as plotësisht dhe në aspektin juridik të çështjes shihet nga aktgjykimi i ankimuar, konstatimi siç citohet në fillim të kryerreshtit të parë të faqes 54 “ të gjitha motrat H. e dinin e gjendja faktike e pronës ishte në kundërshtim me statutin ligjore kur ato nënshkruan dy kontratat e dhurimit kur i dorëzuan ato në Gjykatën Komunale për ti vërtetuar veprat e dhurimit dhe në fund kur kontratat e certifikuara u dorëzuan në Zyrën e kadastrës për të aprovuar ndryshimin e pronësisë ligjore, është konstatim i pa qëndrueshëm dhe bazohet po ashtu sikurse e kemi thënë më lartë vetëm në supozime pasi që me

asnjë provë nuk është vërtetuar që e mbrojtura ime bashkë me motrat e saj të ketë kryer veprën penale Legalizim i përmbajtjes së pavërtetë pasi që e njëjta nuk ka përdorur ndonjë dokument të falsifikuar si provë. Duke pasur parasysh që janë bërë të gjitha këto shkelje aktgjykimi i shkallës së parë sipas mbrojtjes është i pa ligjshëm.

-E akuzuara M.H. pretendon se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që pikat 4,7,8,9 dhe 10 të dispozitivit të aktgjykimit të kundërshtuar janë të pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tyre dhe me arsyet e aktgjykimit, në aktgjykim nuk janë paraqitur arsyet për faktet vendimtare ndërsa arsyet a paraqitura janë plotësisht të paqarta dhe në masë të konsiderueshme kundërthënëse, për faktet vendimtare ka kundërthënie ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetim të aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve për deklaratimet e dhëna në procedurë dhe vet atyre procesverbaleve për çka do të bëhet fjalë më poshtë në këtë ankesë. Aktgjykimi përmban shkelje esenciale të procedurës penale në faktin se gjykata e shkallës së parë disa prej provave fare nuk i ka paraqitur, disa i ka paraqitur në mënyrë selektive e jo në mënyrë të plotë dhe të çartë siç e parashikon dispozita e nenit 170 të KPPK-së, prova të cilën kjo gjykatë fare nuk e ka paraqitur dhe fare nuk e ka vlerësuar as tërësisht e as sipërfaqësisht e as ka shtruar fillimisht e theksojmë se është mbrojtja e të mbrojturit tim por ndaj të njëjtës sillet sikurse mos të ishte paraqitur fare. Shkelja esenciale është bërë në atë që ka të bëjë me përcaktimin e dobisë pasurore, kinse të fituar me veprën penale e që ky konstatim është në kundërshtim edhe me vetveten. Po qese analizohet ky konstatim me vëmendje del që blerjen e shtëpisë – banesës nga Komuna e “...”, babi jonë i ndjerë M.H. e ka blerë edhe të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm të oborrit konform ligjit të aplikueshëm dhe se shfrytëzimi i kësaj toke i takon vetëm atij ndaj nuk mund të bëhet fjalë për çfarë do kërkesë për kompensimin e Komunës së “...” ose ndokujt tjetër sepse ato do të ishin të pa baza. Lidhur me veprën legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë duhet theksuar së për të ekzistuar kjo veprë penale duhet të vihet në lajthim për të vërtetuar një çështje të pa vërtet e cila duhet të shërbej si provë në një çështje ligjore. Unë dhe motrat e mija e kemi besuar dhe besojmë edhe tani se kemi trashëguar nga prindërit një të drejtë të ligjshme të pronësisë në shtëpi dhe të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm të tokës- oborrit ashtu siç është përcaktuar me ligj, vendime gjyqësore legale dhe kontratat e dhurimit të vërtetuar në mënyrë legale në gjykatë, të regjistruar në mënyrë legale në Zyrën Komunale Kadastrale në Prishtinë që janë pjesë e dokumenteve të shkresave të lëndës. Ndërsa lidhur me veprën penale mashtrimi duhet theksuar se për të ekzistuar kjo veprë penale përveç paraqitjes së rrejshme dhe fshehjes së fakteve të personit tjetër duhet të shkatohet dëmi. Unë dhe motrat siç është cekur më lartë nuk kemi ndërmarr asnjë veprim mashtrues. Ndërsa lidhur me veprën uzurpim i kundërligjshëm, nuk mund të uzurpohet sendi i paluajtshëm të cilin personi e ka në posedim, prandaj në rastin konkret nuk formësohen elementet e kësaj vepre penale.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar shkresat e lëndës së bashku me aktgjykimin e atakuar si dhe ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ankesat e mbrojtjes ashtu që vlerëson se këto ankesa janë të bazuara. Aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë dhe konkret, gjykata ka dhënë arsye për faktet vendimtare si dhe arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse dhe arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike. Gjykata në aktgjykimin e shkallës së parë ka

administruar provat personale dhe ato materiale duke dëgjuar si dëshmitar dëshmitarët B.K., R.B., I.M, M.P, M.S, L.R., M.S., N.M., N.K, H.K., S.H., Z.P, N.K, H.B, L.N dhe eksperti D.G. si dhe mendimin e ekspertit për vlerësimin e pronës në fjalë. Nga këto prova gjykata vërtetoi faktet e që kanë të bëjnë me pronën në pjesën e vjetër të “...” që ndodhet prapa Muzeut të Kosovës me të dhënat si në dispozitiva të aktgjykimit ku është vërtetuar se kjo pronë është regjistruar në pronësi shoqërore deri në vitin 2005 e cila fillimisht i përkiste M.H.t që ka vdekur me 17 korrik 2003 i cili ka punuar si minator dhe ishte gjysmë i shkolluar dhe kishte përdor kryesisht alfabetin cirilik ndërsa bashkëshortja e tij A.H. po ashtu ka vdekur me 19 korrik 2011 dhe ishte amvise dhe analfabete. Të njëjtit kishin 6 vajza edhe ato të pandehurat M.H. B., N.M.M, I.H.C., K.H., K.H.U. dhe I.M., dhe se K. është martuar me të akuzuarin N.U. në vitin 1977. Kjo parcelë ishte e regjistruar në emër të 6 motrave dhe si shtëpi e vjetër 97 m2 dhe oborrin prej 69 metrave. Shtëpia është rrënuar në vitin 2003 dhe është ndërtuar një ndërtesë komerciale 4 katëshe në mënyrë të paligjshme në vitin 2004/5 pa leje ndërtimi. Pronësia nga A.H. dhe motrat H. bazohet në aktgjykimin të cilin e ka dhënë gjyqtarja S.M. në vitin 2004 ku e ka bazuar aktvendimin e sajë në dy kontrata me adresa të ndryshme dhe për një apartament prej 72m2. Edhe pse gjyqtarja M.i dhe eksperti H1. zyrtarisht kanë dal në vendin ku është parcela dhe kanë parë ndërtesën komerciale, aktgjykimi dhe raporti i ekspertit i referohen vetëm shtëpisë së vjetër dhe oborrit që nuk ekziston e jo ndërtesës komerciale që ishte ngritur në këtë parcelë dhe ishte dhënë me qera ZRRE. U vërtetua se para marrjes së familjes H. në posedim këtë parcelë L.R. ka jetuar në shtëpinë e vjetër nga viti 1979 deri në vitin 1986 duke paguar çira Ndërmarrjes Publike e që vendimin për ta përdorë shtëpinë e kishte lëshuar M.S., shok i studimeve të N.U. i cili vendim ishte lëshuar me 17. Nëntor 1983, 4 vite pasi L. kishte hyrë në të vërtetë. Pas pensionimit të M.H.t në vitin 1986 familjes së tij i është dhënë një banesë në zonën e Dardanisë në Prishtinë nga Shoqata për personat në pension të cilin ai në po të njëjtin vit e kishte ndërruar këtë banesë me L.R.in e i cili shkëmbim u regjistruar me vendim të Gjykatës Komunale me 6 nëntor 1986 ku lejon shkëmbimin e banesës së sajë në rrugën “...” me banesën e M.H.t në Dardani. Nuk ka dëshmi se rruga H.M. është quajtur ndonjëherë rruga ose sheshi “...” dhe se BVI-Ndërmarrja Publike e Banësive nuk ka administrua prona në zonën rreth Muzeut. Nuk ka dyshim se L. ka jetuar në një shtëpi të vjetër afër Xhamis dhe Muzeut dhe po ashtu nuk ka dyshim se familja H. u zhvendos në këtë shtëpi dhe ka jetuar për një kohë të gjatë. Sipas L. udhëheqësi kryesor i këtij shkëmbimi ishte N.U. të cilin ajo e njihte sepse punonte në kafiterin e Komunës së “...” dhe ka deklaruar se kurr nuk ka jetuar pranë hotel Grandit në rrugën që tani quhet “G..”. M.H. me familje kanë hyrë në shtëpinë e vjetër pranë Muzeut duke lidhur kontratë me BVI me 26 Nëntor 1986 duke lidhur kontratë ku autorizohet M. për ta shfrytëzua apartamentin 72m2 në rrugën “...” nr. 1/A ndërsa askund nuk përmendet parcela toksore 5602. Më vonë M. ka blerë banesë në rrugën “...”-rr.enr. 1 me 8 shkurt 1993. Me kontratë e cila specifikon në mënyrë specifike qëran për një kohë të kufizuar. Gjykata Komunale në Prishtinë ka vërtetuar shitjen me vërtetim 12702/93 të dt. 2.dhjetor 93 dhe kërkun nuk përmendet fjala parcelë 5602 dhe është kontratë ku për herë të parë që ka referencë fjalën “...” apo (e S....) që është bërë në lidhje me apartamentin në sheshin “...” nr. 1/A që është rruga jashtë “...” në jug drejt qytetit të Shkupit. Me 1991 M. ka apliku për leje ndërtimi për një lokal afarist në parcelën 5602 e cila i është refuzuar me arsyetim se ndërtesa ishte në pronësi të Komunës dhe jo në pronësi të tij. Përsëri M. ka kërkuar leje dhe memorandumin nder instalues i Institutit të Planifikimit Urban të Komunës së “...” ka përshkruar kushtet që duhet të plotësoheshin për ndërtim dhe këto punë nuk janë kryer në atë kohë. Kjo parcelë me 21 dhjetor 2000 është përshkruar për zyrën e kadastrit nga F.H. duke përfshi matjet dhe planet ku tregojnë ekzistencën e një shpie 97m2 dhe një oborri 69m2.

Me 4. Shkurt 2001 M.H. përsëri ka kërkuar leje ndërtimi kjo leje është marrë nga N.U. ku nga dosja e projektit tregohen planet e ndërtimit për një shtëpi tradicionale. Leja e ndërtimit ka kërkuar rindërtimin e një shtëpie tradicionale me karakteristika tradicionale për të ja përshtatur zonës për rreth duke përfshirë se do të dukeshin dyert dhe dritaret prej druri dhe qatia me tjegulla dhe se duhet të njoftohet Komuna dhe inspektorët se ndërtimi po behët sipas lejes. Thuhet po ashtu se leja e ndërtimit nuk krijon asnjë të drejtë ligjore ose të ngjashme në tokë. Po ashtu është lejuar një kohë e zgjatjes për përpunimin e rindërtimit ku është konstatuar se N.U. e ka ndihmuar vjehrrin e tij lidhur me lejen e ndërtimit. Është konstatuar se shtëpia e vjetër u rrënuar në vitin 2003 duke shkelur lejen ndërtimore e ku familja H./U. ndërtoi ndërtesë komerciale me xhama dhe çelik prej 800 m² e cila përfundoi në prill të vitit 2005 duke mbuluar përafërsisht 166 m² domethënë të gjithë tokën brenda parcelës tokësore. Pronarët e mëparshëm kanë bërë kërkesë për rivendosje të të drejtave të tyre pronësore mbi këtë parcelë në gusht të vitit 2002 të iniciuar nga vëllezërit I., A., H. dhe H.H. (H) e ku sipas gruas së njërit prej tyre N.B. rasti ishte evidentuar me numër C.839/02 dhe ishte caktuar te gjyqtarja S.M. ku kërkesa ishte bërë nga R.B.. Pretendimi tregon se kjo parcelë ishte regjistruar në emër të familjes H. ku gjykata ka përshkruar në faqen 19 pretendimin e kësaj kërkesë e që gjatë bastisjes në shtëpinë e N.U. një kopje e kësaj padie është gjetur aty që tregon se i njëjti ishte në dijeni për këtë proces edhe pse ai por as familja E. nuk ishte palë në këtë rast. Avokati R.B. pa pëlqimin e palëve ka tërhequr padinë në seancë para gjyqtarës S.M.. Arsyetimi i R.B.t ishte se gjyqtarja asnjëherë nuk bën asgjë pa dijeninë e kryetarit dhe se ajo ishte shërbëtore e tij se nuk ka pas raporte të mira me gjyqtaren dhe se ka pas përshtypje se ajo ka qenë nën ndikim të kryetarit. N.B. ka angazhuar avokat tjetër dhe padinë e ka zgjeruar edhe kundër N.U. pasi “si shfrytëzues i shtëpisë ka rrënuar dhe rindërtua shtëpinë dhe është kërkuar që të vendoset masa e përkohshme për të paditurin N.U. për ta pezulluar menjëherë punimin në ngastrën 5602. Gjykata ka përshkruar veprimet e avokatit M.P. lidhur me këtë padi. Me 14 tetor 2003 M.H. kërkoi në Gjykatën Komunale të “...” vërtetimin e pronësisë të parcelës 5602, një javë para se R.B. ta tërheq padinë. Kjo padi e M.H.t është caktuar te gjyqtarja S.M. e cila ishte e vetëdijshme se ka pas pronësi të kontestuar në lidhje me këtë parcelë e duke qenë e vetëdijshme se shtëpia dhe oborri ishin rrënuar pasi kjo ishte pohuar në padinë e familjes H.. Në këtë padi M. ka përdorë kontratën për shfrytëzim të Sheshit “...”, kontratën për blerje po në këtë vend, dokumentacionin nga një apartament 72 m² në rrugën “...” që tani quhet “G.” e ku shihet se të gjitha parcelat e tokës në këtë rrugë përmbajnë 5 shifra e jo 4 shifra . Në ndërkohë M. ka vdekur dhe procedura ishte ndërpre dhe kërkesa u paraqit nga E. U., vajza e N.U.. Ky fakt që ku vajza e kryetarit të gjykatës paraqet kërkesë në emër të vjehrrive të kryetarit do të thoshte se N.U. është dashur ta paraqiste kërkesën në një gjykatë tjetër me qëllim që ta parandalonte çdo paragjykim. Me 22.mars 2004 N. H. parashtrroi kërkesë për fillimin e procedurës trashëgimore në po këtë gjykatë e cila i referohet një shtëpie në rrugën e Sh.... me listë poseduese 4137 si parcelë tokësore 5602. Kjo kërkesë mbështetet në kontratën e blerjes 12702/93 të dt. 02.12.93 e cila i referohet vetëm një apartamenti prej 72 m². Me 31.mars 2004 A.H., e veja e të ndjerit M. u bë trashëgimtarja e vetme dhe pastaj u bë paditëse në rastin e mësipërm. Aktvendimi përmend përdorimin e oborrit në pronën 5602 duke i dhënë vendimi i trashëgimisë A. 97m² në vend të 72 m² që ka blerë M. dhe se gjyqtarja I.SH. nuk e ka sqaruar fare këtë ndryshim duke fituar e njëjta më shumë të drejta se sa personi i vdekur që ka poseduar. Ky vendim trashëgimie është përdorur më vonë për ta mbështetur padinë nr. 424/04. Gjyqtarja S.M. mbajti seancën gjyqësore dy javë më vonë me 18 maj 2004 dhe kjo padi u trajtua në Gjykatën ku dhëndri i paditësve ishte kryetari i sajë. Nga procesverbali i seancës 30.06.2004 avokati i Komunës paraqiti se “bazuar në kontratën e shitblerjes, paditësi është pronar vetëm i ndërtesave të ndërtuara në këtë tokë por jo edhe

pronar i tokës duke mos ngritur pyetje në lidhje me dallimet në zonën ose emrin e rrugës. Me 30.06.2004 gjykata me gjyqtaren S.M. konstatoi se paditësja A.H. është pronare e parcelës 5602 dhe ka të drejtë shfrytëzimin e përhershëm të oborrit dhe se kjo bazohet në kontratën për shfrytëzim të dt. 26.11.1986 dhe kontratën për shitje nr. 12702/93 dhe duke mos bërë asnjë referencë se banesa subjekt i këtyre kontratave kishte 72m². Se ky vendim është i kundërligjshëm tregon fakti se nuk ka mundur ti jepet personit privat përdorimi i përhershëm i pronës shoqërore pastaj se vendimi për pronësinë u bazua në dokumentet që përbëjnë dy adresa krejtësisht të kundërta dhe e treta e injoroi ndryshimin e madh në metra katror në mes të apartamentit 72m² dhe pronës prej 166 m². Gjykata po ashtu dha arsyetimet edhe me sistemin e alokimeve të rastit dhe ku u arsyetua se gjyqtarja sipas këtij sistemi merrte vetëm lëndët që përfundonin me numër 1 ndërsa rasti i A.H.t kishte numrin 424 që sipas këtij sistemi duhet ti caktohej gjyqtarës N.H.. Edhe rasti i vëllezërve H. duhej ti caktohej gjyqtarit që përfundon lënda me numrin 9 e ku gjyqtare është G.S. ndërsa e ka marrë përsipër gjyqtarja O.J.. Edhe vetë i akuzuari N.U. ka konfirmuar se sistemi i alokimit të lëndëve nuk ishte respektuar gjithmonë kur ai ishte kryetar sidomos kur gjyqtarët ishin të mbingarkuar atëherë i është caktuar te gjyqtarët tjerë edhe pse gjyqtarja S.M. ka thënë se lista e lëndëve nuk ishte e mbingarkuar në vitin 2004 dhe se atëherë ishte normale që seanca të mbahej për 11 ditë nga marrja e padisë siç ndodhi me padinë e A.H.t. Vendimi i gjykatës Komonale në Prishtinë i marr nga gjyqtarja S.M. është apeluar në Gjykatën e Qarkut me datën 30.06.2004 e cila pastaj u vërtetua nga Gjykata e shkallës së dytë. Pas kësaj me datën 03.01.2005 u bë kërkesa për transferim të pronës në Zyrën Kadastrale në Prishtinë kërkesë kjo për transferimin e pronësisë për tërë parcelën dhe pavarësisht kësaj kjo zyre e pranoi kërkesën e saj duke transferuar në mënyrë të paligjshme pronësinë e parcelës së plotë të pronës 5602 për A.H. dhe në vendimin e Komunës të nënshkruar nga drejtori i zyrës kadastrale S.H. jepej arsyetimi se pse është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi. Me 22.02.2005 A.H. me një autorizim të vërtetuar duke vendosur gishtin e saj në autorizim, autorizoj djalin e N.U., nipin e saj M. U. që të mund të shes, jep me qira ndërtesën në parcelën tokësore 5602 e ku më vonë i njëjti ka nënshkruar një ofertë në ZRRE për qira të zyrave të ndërtesës duke ia dhen me qira mujore prej 4.130 €. Kjo kontratë e nënshkruar në mes ZRRE dhe të pandehurës M.H. B. u gjet në apartamentin e N.U. gjatë bastisjes me 20.03.2013. Është vërtetuar nga të dhënat financiare se M. U. dhe M.H. ishin përfitues të pagesave. Po ashtu A.H. autorizoj M. U për qasje në llogarin e saj bankare dhe se ky autorizim u vërtetua në Gjykatën Komonale në Prishtinë nga T.U., i afërm i N.U. dhe zyrtar në këtë gjykatë dhe se quditërisht ky dokument nuk është regjistruar në librin e regjistrimit në Gjykatën Komonale të "...". Po ashtu edhe aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut është apeluar me revizion në Gjykatën Supreme ku me vendimin Rev.144/2005 u anulua aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut dhe një pjesë e aktgjykimit të Gjykatës Komonale duke vërtetuar pronësinë e shtëpisë ndërsa për oborrin prej 69 m² nuk i takon paditëses pasi është pjesë e pronës shoqërore dhe si e tillë nuk mund të transferohej asnjëherë si dhe hodhi poshtë dhënien e përdorimit të oborrit të A.H.t duke e kthyer lëndën në rigjykim ku përsëri u caktua tek gjyqtarja S.M.. Me 26.06.2006 gjykata doli në teren me ekspertin e gjeodezisë F.H., avokatin e Komunës Z. K. dhe avokatin e zonjës H., avokatin H.G.. Asnjë nga zyrtarët nuk përmendi faktin se shtëpia dhe oborri ishin rrënuar dhe se vendi tani përbëhej nga një ndërtesë komerciale të ndërtuar në mënyrë të paligjshme duke pamundësuar ekzekutimin e dhënë nga Gjykata Supreme duke mos pasur mundësi që të matet ndonjë rrugë. Kanë ekzistuar katër raporte të ndryshme të gjeodezisë njëri i datës 26.06.2006 i cili është gjetur në apartamentin e N.U. ku përfshihesin fotografitë ajrore po që nuk ishin në dosjen e gjykatës. Raporti i datës 11.07.2006 ku përmenden dy garazha dhe i gjetur fizikisht në dosjen e gjykatës por nuk ishte i

regjistruar në atë dosje të gjykatës dhe përfundimisht harta e re (d) i është dhënë prokurorit në mars të 2013 e ku shihet se F.H. pasi e kupto se ishte nxën u përpoq ti mbulonte veprimet e tij. Gjyqtarja M1. injoroi vendimin e Gjykatës Supreme duke dhënë një vendim të dytë pothuajse të njejtë të vitit 2004 duke i dhënë të drejtën e përdorimit të përhershëm të oborrit në parcelën tokësore nr. 5602. Edhe ky vendim u apelua nga avokati i Komunës N.K. por 3 ditë pas skadimit të afatit ashtu që gjyqtarja ankesën e Komunës e Hudhi si të paafatshme duke e bërë aktgjykimin përfundimtar. Qiraja totale e marrur nga ndërtesa komerciale në parcelën 5602 nga familja H./U. në mes 2005 dhe 2012 arrin shumën prej 336,825.67 €. Një padi e re me numër 2133/09 për pronësinë e gjithë parcelës tokësore nr. 5602 në sipërfaqe prej 166 m² është bërë në emër të A.H.t e cila në atë kohë kishte 85 vjet duke e mbështetur padinë në aktgjykimit të vitit 2006 duke pohuar se lokalet tregtare janë ndërtuar në përputhje me lejen e ndërtimit e që ishte ndarë te gjyqtarja N.H. por që ishte tërhequr me arsyetim se aktgjykimi 807/06 i datës 26.07.2006 kishte përfunduar qështjen me 23.09.2010 K.H. dhe K.U. nënshkruan kontratën mbi dhuratën me nënën e tyre A.H. në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 24.09.2010 ku i dhurohej parcela 5602 e ku në këtë kontratë theksohej se objekt i kësaj kontrate është prona e paluajtshme në rrugën H.M. numër 1 e regjistruar në fletën poseduese me numër UL-71814059-11117 ZK Prishtinë si parcelë 5602 me shtëpi prej 97 m² dhe oborr prej 69 m² në sipërfaqe të përgjithshme prej 166 m² pas kësaj kjo kontrat u dorëzuar në Zyrën Kadastrale në Prishtinë ku kjo zyre nxorri vendim me 06.10.2010 për transferimin e pronës nga A. në K1. dhe K2 pas kësaj K1 dhe K2 autorizuan M.U. për të ndërmarr veprimet e nevojshme për dhënien e ndërtetsë me qira e cila gjendet në këtë parcelë. Me 21.10.2010 K1. dhe K2. hyn në një kontratë të dytë dhurime me 4 motrat e tyre M.H.n, N.M., H.M. dhe I.C., në bazë të kontratës të vërtetuar në gjykatë duke e ndarë në 6 pjesë të barabarta. Kështu të 6 motrat vazhdojnë të mbeten në mënyrë të paligjshme në posedim dhe uzurpim të parcelës 5602 e cila me të drejtë i takonte Komunës së "...". Kjo parcelë aktualisht është e regjistruar në kadastër në pronësi të 6 motrave ku përshkruhet një shtëpi dhe oborr dhe nuk ka ndonjë referencë se është zëvendësuar në vitin 2004/5 nga një ndërtesë tregtare me 4 kate. Në dhjetor 2012 kjo ndërtesë u mor me qira nga PBC për një periudhë 5 vjeçare e cila qira do të paguhej në llogarinë e K.H.t e cila është ngrirë me 18.04.2013 në bazë të urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake. Me 24.09.2010 A.H. bëri kërkesë për legalizimin e objekteve të ndërtimit në Komunën e "...” dhe nga Komuna është konfirmuar se procedura e legalizimit ka filluar dhe se do të nxirret një përfundim pas procesit, ndërsa në përgjigje pyetjes së prokurorit Komuna ka konfirmuar se ky proces i legalizimit është në pritje se paisja e fshehur për dëgjim ka regjistruar N.U. duke thënë se me 16.07.20132 “ u bë kërkesa për legalizim, për lejen për tejkallim” . bazuar në këto që u tha më lartë pa mëdyshje u vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve qëndrojnë të gjitha elementet për të cilat ata janë akuzuar dhe shpallur fajtor pavarësisht faktit se për disa prej tyre ka rritur parashkrimi i veprës penale. Sa i përket parashkrimit kjo gjykatë konsideron se pretendimet e prokurorit janë të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë një arsyetim të thukët dhe të arsyetuar bazuar edhe në literaturë shkencore e që ka të bëjë me parashkrimin e që në rastin konkret për të akuzuarit për të cilët gjykata e shkallës së parë ka marr aktgjykim refuzues ky parashkrim ka arritur. Janë plotësuar dy elemente të parashkrimit si që është koha kur është kryer vepra penale dhe kur vepra është ndërmarr me qëllim të ndjekjes penale të veprës penale të kryer. Aktakuza e ngritur e datës 24.09.2014 sjellë akuzat e kryera në datën e caktuar ose brenda afatit të caktuar kohor ku gjykata e shkallës së parë edhe i përshkruan në faqen 36, 37, 38, 39 dhe 40 të aktgjykimit e ku për secilën veprë penale gjykata e shkallës së parë në faqen 41 të aktgjykimit të shkallës së parë (verzioni në gjuhën shqipe) ka pasqyruar afatat të cilat parashihen me nenin 106 të KPRK-së dhe nenit 90 të KPK-së. për veprën penale nxjerrja e

vendime të kundërligjshme gjyqësore që ka të bëjë me S.M. afati është 5 vjeçar që fillon me datën 26.07.2006 dhe përfundon me 26.07.2011 ndërsa aktvendimi për fillimin e hetimeve është lëshuar me 29.11.2012 pra pas kalimit të afatit ligjor të parashkrimit. Njëjtë është edhe sa i përket veprës penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare ku është kryer në mes 22.02.2006 dhe 26.07.2006 që ka të bëjë me N.U., S.M. dhe F.H. ku kodi i ri është më i favorshëm dhe parasheh dënimin deri në 5 vjet e që fillon prej 26.07.2006 dhe përfundon me 26.07.2011 ndërsa aktvendimi për fillimin e hetimeve është lëshuar me 29.11.2011 . Edhe për veprën penale të mashtrimit nën pikën 5 e kryer me 22.02.2006 dhe 22.09.2006 për të akuzuarin N.U., F.H. dhe S.M. ku parashihet dënimi deri në 5 vjet e që mbaron me 22.09.2011 e që aktvendimi për fillim të hetimeve është lëshuar me 29.11.2012, prandaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë në këto tri vepra penale mori aktgjykim refuzues, duke dhënë arsytet edhe sa i përket ndërprerjes nëse kryesi kryen ndonjë vepër penale me peshë të barabartë ose me peshë më të madhe se vepra e përparshme para skadimit të afatit të kufizimit ligjor koncept ky i njohur edhe në kodin e mëhershëm të procedues penale por edhe në kodin e procedurës penale të Jugosllavisë. Sa i përket krimit të organizuar gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se dispozita e nenit 274 dhe tani në kodin e ri e nenit 283 nuk është vërtetuar se vepra të tilla kriminale të krimit të organizuar janë kryer . gjykata e shkallës së parë ka përshkruar elementet që përmban vepra penale e krimit të organizuar duke theksuar se kryesi duhet të veproj me synimin dhe njohurin e qëllimit dhe të veprimtarisë së përgjithshme të grupit të organizuar kriminal ose qëllimin e tij për të kryer një ose më shumë vepra penale të cilat dënohen me burgim e që në rastin konkret nuk ka vend për dyshim për nevojën e një synimi të drejtëpërdrejtë e që për ta kryer veprën penale të krimit të organizuar duhet që së pari të kryhet vepra penale bazë apo themelore si kërkesë e veprës penale të krimit të organizuar e ku kërkohet kryerja e një vepre penale përveç asaj të krimit të organizuar vet.

. Pavarësisht pretendimit të prokurorisë se N.U. ishte organizator i kësaj ndërmarrje që ka planifikuar, organizuar ate në bazë të njohurive ligjore që kishte si dhe pozicionit të tij dhe marrëdhëniet me gjyqtaren S.M. dhe ekspertin F.H. nuk u vërtetua se një organizatë e tillë kriminale ka ekzistuar ndonjëherë pasi që kjo nuk u mbështetë nga asnjë provë të vetme dhe të besueshme që do të kishte paraqitur dhe mbështetur qëllimin e drejtëpërdrejtë jo vetëm të motrave H. por as gjyqtarës M1. e as të ekspertit H. për tu angazhuar në një vepër penale të krimit të organizuar. Familja H. nuk organizoi rrjetin kriminal për të përvetësuar pronën e njerëzve të tjerë por për ta legjitimuar statusin ligjor të kësaj prone mirëpo me mjete të paligjshme për të arritur këtë plan. Prandaj ka munguar grupi i strukturuar dhe i organizuar që do ta vërtetonte këtë pretendim të prokurorisë. Gjukata e shkallës së parë ka arsyetuar drejtë çështjen e legalizimit të përmbajtjes së rreme dhe të veprës penale të mashtrimit e që ka të bëjë edhe me procedurën e transferimit të pronës e po ashtu edhe sa ju përket kontratave të dhurimit nga nënshkruesit e këtyre kontratave e që qëllimi ishte shfaqja e rreme për ta shtyer Komunën e “...” të veproj në dëm të saj dhe të nënshkruar për të gjithë parcelën tokësore 5602 përfshirë këtu edhe oborrin në pronësi shoqërore nga A. tek dy vajzat e saj pa e vërejtur se ka dallime shumë të mëdha mes asaj çka u dokumentua dhe asaj çfarë ndërtimi ekzistonte në të vërtetë dhe se pa vërejtur se ajo kurrë nuk duhet të ishte regjistruar në emër të A.H.t. Po ashtu edhe gjatë dhurimit të dytë që është bërë nga motrat K1. dhe K2. në katër motrat tjera paraqet edhe një vepër tjetër të legalizimit të përmbajtjes së pavërtetë duke vërtetuar në kontratë ekzistencën e një shtëpie të vjetër dhe një oborri edhe pse të gjithë e dinin se kjo shtëpi e vjetër nuk ekzistonte. Gjukata e shkallës së parë drejtë ka vendosur sa i përket dëmit material që i është shkaktuar Komunës së “...” duke ardh në

përfundim se ky dëm tejkalon shumë prej 15.000,00 € duke e bazuar këtë në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të datës 22.06.2006 dhe vlerësimin e vlerës së dhënë nga eksperti. Gjykata po ashtu ka paraqitur përmbajtjen e aktgjykimit të Gjykatës Supreme por me një element të rëndësishëm që nuk është paraqitur në këtë aktgjykim e që ka të bëjë me ndërtesën e vjetër historike e rrëzuar në vitin 2003 dhe një ndërtesë të re moderne e cila ka zënë tërë pronën por sipas gjykatës së shkallës së parë e që e përkrahë edhe kjo gjykatë kjo nuk e bënë të pavlefshëm vlerësimin ligjor të dhënë nga Gjykata Supreme pasi ajo ka theksuar se ngastra është pronë e Komunës së “...” dhe nuk kishte mjet ligjor për ta ndryshuar statusin e saj prandaj çdo përpjekje e familjes H. ku pohojnë se toka gjithashtu i është dhënë atyre konsiderohet e paligjshme. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk pajtohet me tezën e aktakuzës lidhur me dëmin material nga të ardhurat e qiras për periudhën 2005-2013 pasi kjo llogaritje bazohet në supozim se kur ndërtesa është ndërtuar në mënyrë të paligjshme në tokë të komunës ajo fiton të drejtën e përfitimit nga qiraja dhe se kjo nuk është argumentuar ligjërisht dhe asnjë dispozitë ligjore nuk u theksua si bazë për një vlerësim të tillë dhe se me të drejtë gjykata ka theksuar se vlerësimi i dëmit material shpie në një mosmarrëveshje civile mbi këtë pronë në një kontest civil pranë gjykatës kompetente por jo në procedurë penale e cila këtu vendos vetëm për përgjegjësinë penale të akuzuarve. Sa i përket veprës penale uzurpim i kundërligjshëm i pronës së paluajtshme gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se për tu kryer kjo vepër penale duhet okupimi i pronës së paluajtshme të tjetrit që kryhet përmes veprimeve të ndryshme dhe se për ta kryer këtë vepër penale duhet të ekzistoj dashja që përfshinë vetëdijen se ai ose ajo ka uzurpuar pronën e tjetrit pa lejen e pronarit legjitim e që me këtë rast ky pëlqim nuk është e nevojshme të jetë formal me shkrim por mundet edhe me gojë. Të gjitha motrat H. tani të akuzuara kanë qenë të vetdishme se pronarë i kësaj paluajtshmërie është Komuna e “...” dhe se vendimet e marra në rastin e tyre dhe që u është dhënë e drejta e pronësisë janë marr me mashtrim me ndihmën e N.U..

Duke vendosur përkitazi me vendimin mbi dënim si dhe ankesat e bëra në këtë drejtim kjo gjykatë vlerëson se këto ankesa janë të pabazuara. Mbrojtësit nuk kanë cekur ndonjë rrethanë të re e që nuk ka qenë e njohur për gjykatën e shkallës së parë, dhe se gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me vendimin mbi dënim si që janë për të akuzuarën K.U. se e njëjta më parë ka qenë e padënuar se është e martuar dhe ka fëmijë, për K.H. po ashtu se e njëjta nuk ka qenë e dënuar, se është zyrtare në Komunën e Obiliqit, e martuar dhe ka fëmijë, ndërsa për të akuzuarat M. H., H.M. dhe I.C., se nuk janë më parë të dënuara se janë të punësuar dhe janë të martuara dhe kanë fëmijë, me të drejtë të akuzuarave ua ka kushtëzuar dënimet për periudhën e verifikimit prej 2 vitesh me bindje se me këtë dënim të shqiptuar mund të arrihet qëllimi i dënitimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Edhe sa i përket vendimit për konfiskimin e sendeve ankesat po ashtu në këtë drejtim janë të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se kot ka pasur dyshime për pasurit e depozituara në llogaritë bankare se ato janë të fituara nga vepra penale gjegjësisht qiraja e mbledhur nga ndërtesa e paligjshme e ndërtuar në parcelën e përvetësuar. Se konstatimet përfundimtare të gjykatës që i mbështetë edhe kjo gjykatë janë se ngastra e tokës 5602 ka pronar legjitim Komunën e “...” e që është vërtetuar edhe nga vendimi i Gjykatës Supreme 144/2005 i datës 22.02.2006 dhe se çdo vendim tjetër i nxjerr në këtë kontest është i paligjshëm. Se nuk është vërtetuar nëse ndërtesa është ndërtuar nga burime financiare të fituara drejtpërdrejtë nga vepra penale kështu që nuk është parashtruar kërkesa për konfiskim të kësaj ndërtese por është

parashtruar kërkesa për rrënimin e saj me urdhër të Komunës. Se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nuk ka kompetencë në këtë drejtim por këtë kompetencë e ka Komuna e “...” për të vendosur se a do të filloj procedurën administrative për rrënimin e ndërtesës në fjalë por jo me vendim të gjykatës në procedurë penale. Po ashtu me të drejtë ka theksuar se duhet të merren parasysh dispozitat ligjore të ligjit mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore dhe se Komuna e “...” dhe motrat H. sa i përket të ardhmes së kësaj shtëpie janë udhëzuar në kontest civil.

Meqë aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të ligjit penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.455/2017, më 16.04.2018

Procesmbajtësi,
Eroll Gashi

Kryetari i kolegjit- gjyqtari
1. Fillim Skoro _____

Anëtarët e kolegjit:

2. Abdullah Ahmeti _____

3. Xhevdet Abazi _____

PAGE

PAGE 19

